VENDIM
Nr. 549, datë 27.8.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË QYTETIN E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura në qytetin e Korçës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjellës - Kanalizime, sh.a., Korçë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë truall, me vlerë të përgjithshme 12 025 090 (dymbëdhjetë milionë e njëzet e pesë mijë e nëntëdhjetë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 12 025 090 (dymbëdhjetë milionë e njëzet e pesë mijë e nëntëdhjetë) lekësh të përballohet nga buxheti i shtetit, zëri "Detyrimet e prapambetura" (detyrimet e infrastrukturës).
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Ujësjellës - Kanalizime, sh.a., Korçë.
6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.
7. Ujësjellës - Kanalizime, sh.a., Korçë të kryejë likuidimin e pronarëve në bazë të dokumentacionit të pronësisë, konfirmuar nga ZVRPP-ja Korçë, në bazë të pikave 3, 4 dhe 6, të këtij vendimi.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Korçë, në bashkëpunim me Ujësjellës - Kanalizime, sh.a., Korçë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e sipërfaqes së shpronësuar mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Ujësjellës - Kanalizime, sh.a., Korçë. Me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së sipërfaqes së objektit mbi hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ujësjellës – Kanalizime, sh.a., Korçë dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve, pasuria në pronësi të të cilëve preket nga kalimi i tubacionit kryesor të ujërave të përdorura pranë superstradës Korçë-Bilisht, tubacion kryesor, i cili derdh ujërat në impiantin e trajnimit Korçë

Nr.	PRONARI			Zona Kadast.	Nr. pasurisë	Sipërfaqe TRUALL (m2)	Çmimi (leke/m2)	Vlera (në lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	Stavri Heri Zhaneta Vjollca Theodhora Sonil Anesti	Anesti Anesti Stavri	Pojani Pojani Bode Bode Bode Bode Bode	8561	8/148	828	11155	9,236,340	Konfirmim ZRPP
2	Shefqet Nimete Suzana Bledar Manjola	Ismail Ismail Sali Selami Piro	Haxhi Kushe(Haxhi) Haxhi(Pulaha) Haxhi(Pulaha) Afezolli	8561	8/972	250	11155	2,788,750	Konfirmim ZRPP
Vlerat Totale Shpronësimit								**12,025,090**	